



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.50/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët; Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Ferizaj vendvotimi nr. 2534/1, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 15.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Ferizaj vendvotimi nr. 2534/1, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.50/2026, të datës 12.06.2026, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, lidhur me veprimeve të kundërligjshme të komisionerit të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Albunit Murati, gjatë procesit të numërimit të votave dhe futjes së të dhënave në sistemin kompjuterik në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Ferizaj, për Vendvotimin nr. 2534/1, me anë të së cilës kontestohet rregullsia e procesit të numërimit të votave dhe futjes së të dhënave në sistemin zgjedhor për kandidatët në Komunën e Ferizajt, për shkak të shkeljeve të rënda të rregullave zgjedhore, tjetërsimit të qëllimshëm të vullnetit të votuesve dhe dyshimit të bazuar për manipulim të koordinuar politik. Parashtruesi i ankesës thekson se gjatë procesit të numërimit të votave dhe regjistrimit të tyre në sistemin kompjuterik në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Ferizaj, konkretisht në tavolinën e caktuar për Vendvotimin 2534/1, me datë 10.06.2026 rreth orës 17:00 komisioneri i deleguar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Albunit Murati, me adresë në rrugën "Rexhep Bislimi" pn., i cili ishte i ngarkuar me detyrën e futjes së votave në sistem, ka

anashkaluar qëllimisht dhe nuk ka regjistruar votën e vlefshme të fituar nga kandidatja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Kaltrina Lohaj. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo tendencë direkte për manipulimin e rezultatit dhe dëmtimin e kandidates sonë është vërejtur në momentin e kryerjes nga vëzhguesi i certifikuar i PDK-së, Blerim Asllani, dhe është dëshmuar drejtpërdrejtë nga komisioneri tjetër në atë tavolinë, Ibrahim Latifi, dhe se pas reagimit të menjëhershëm dhe këmbënguljes së tyre ky "gabim" është korrigjuar në vend, duke u regjistruar vota e kandidates Kaltrina Lohaj në sistem ashtu siç figuronte saktësisht në fletëvotim. Parashtruesi i ankesës thekson se ajo që e zhvendos këtë rast nga një "lëshim teknik" në një dyshim të bazuar për manipulim të qëllimshëm, është identiteti i vetë kryesit të këtij veprimi i komisioneri i LVV-së, Albunit Murafi, me adrese në Ferizaj rruga "Has është vëllai i Ministrit të Financave, Hekuran Murati. Lidhja e ngushte familjare me një ndër eksponentët më të lartë të partisë në pushtet dhe qeverisë, shpërfaq një motiv pastër politik dhe ngre dyshime serioze për një qasje selektive, të qëllimshme dhe tendencioze ndaj votave të kandidatëve të PDK-së, me theks të veçantë ndaj kandidates sonë. Si rrjedhojë, ekziston frika dhe pretendimi i bazuar se ky veprim nuk ka qenë i izoluar, por mund të jete pjesë e një praktike të përsëritur nëpër tavolina të tjera të numërimit nga komisionerët e të njëjtit subjekt politik ku ka munguar vëzhgimi strikt, duke cenuar rëndë integritetin e të gjithë procesit zgjedhor në Komunën e Ferizajt. Për vërtetimin e plotë të thënieve të mësipërme, parashtrojmë këto prova: dëshmia me dëshmitarëve: Blerim Asllani (Vëzhgues i PDK-së me nr. tel: [REDACTED], në cilësinë e dëshmitarit okular që ka identifikuar dhe denoncuar shkeljen ndaj kandidates Kaltrina Lohaj, Ibrahim Latifi (Komisioner me nr. tel [REDACTED], në cilësinë e dëshmitarit që ka asistuar dhe konfirmuar parregullsinë e tentuar. Njoftimi zyrtar: fakti që menjëherë pas ndodhjes së rastit, formalisht është njoftuar anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Ferizaj, Burhan Salihu me nr. tel [REDACTED]

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që në kuadër të autorizimeve ligjore, të urdhërojë administrimin dhe rishikimin e video-incizimeve nga kamerat e sigurisë të KQZ-së / QKN-së për tavolinën e Vendvotimit 2534/1 ku ka shërbyer komisioneri Albunit Murati, si dhe verifikimin e procesverbaleve dhe regjistrin e ndryshimit të të dhënave në sistem. Mbi bazën e rrethanave të shtjelluara dhe me qëllim të mbrojtjes së ligjshmërisë, objektivitetit dhe votës së lire të qytetarëve, i propozojmë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia që të aprovohet si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), të konstatohet shkelja e procedurave të numërimit dhe tentim-manipulimi i të dhënave të kandidates Kaltrina Lohaj nga komisioneri i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Albunit Murati, në QKN Ferizaj, dhe të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që, për shkak të cenimit të rëndë të integritetit të procesit dhe dyshimit të bazuar për manipulim të shtrirë e të koordinuar, të dërgojë në rinumërim të plotë vendvotimet/kutitë e votimit për Komunën e Ferizajt,

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se KQZ-ja, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), si dhe Procedurën Standarde të Veprimit për Aktivitetet në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet e Parakohshme

për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të miratuar më 26.05.2026 me nr. 01/989/2026, përcaktohen procedurat e detajuara që rregullojnë themelimin,, funksionimin dhe menaxhimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN). Këto procedura përfshijnë gjithashtu mbikëqyrjen e procesit, pranimin dhe kontrollimin e materialit zgjedhor, verifikimin dhe numërimin e votave, si dhe trajtimin e ankesave që lidhen me procesin e punës në QKN. Bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Gjithashtu, sipas nenit 5, paragrafët 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet kryesore QKN-së përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në përputhje me nenin 14, paragrafin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), rezultatet të dala nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në rastet kur gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit konstatohen pasaktësi, mospërputhje ose gabime në evidentimin e rezultateve. Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2024 për Rezultatet Zgjedhore, neni 9, paragrafi 1, përcakton se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim (VV), ose edhe përsëritjen e votimit në një vendvotim (VV) apo qendër votimi (QV)."

KQZ, pas pranimit të kërkesës nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ka kontaktuar menjëherë Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Ferizajt, nga i cili ka pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: "Në Qendrën Komunale të Numërimit Ferizaj janë zbatuar të gjitha procedurat e caktuara në bazë të rregullës zgjedhore për Qendrën Komunale të Numërimit andaj lidhur me ankesën në fjalë mund të konstatojë: se të gjitha tavolinat kanë pasur vëzhgues të cilët kanë monitoruar procesin e numërimit - asnjë vëzhgues dhe asnjë anëtarë nuk ka bërë vërejtje për procesin e numërimit (nuk kemi asnjë vërejtje në librin e votimit ku kanë mund të shënohen edhe vëzhguesit edhe anëtarët e ekipit të numërimit) për më tepër nuk kemi pasur as ankesë verbale. Anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor i cili ka qenë te ajo tavolinë, vetëm ka përcjellë procesin dhe ka deklaruar se çdo gjë ka qenë sipas rregullave zgjedhore të Qendrës Komunale të Numërimit dhe se votat në tavolinën e përmendur në ankesë janë shënuar sipas procedurës standarde të veprimit në QKN. Neve si Komision Komunal Zgjedhor nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga kjo tavolinë as të shkruar, po as verbale për të ndërmarrë apo shqyrtuar këtë ankesë në Qendrën Komunale Numërimit Ferizaj, anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor i cili ka qëlluar në vëzhgim të kjo tavolinë ka qenë i të njëjtit subjekt me ankuesin dhe ka deklaruar se në atë tavolinë votat janë shënuar saktë". (Shih të bashkangjitur deklaratën e ZEKKZ). Pala ankuese, në bazë të veprimeve të përshkruara në ankesë lidhur me pretendimet për shkelje të rregullave zgjedhore dhe tjetërsim të qëllimshëm të votave të votuesve gjatë procesit të numërimit në QKN nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme në mbështetje të këtyre pretendimeve, përfshirë: formularët e rezultateve të subjekteve politike, librin e votimit në QKN, deklaratat e ekipeve të numërimit në QKN apo materiale të tjera zgjedhore që do të dëshmonin se ka pasur parregullsi, etj. Në kuptim të nenit 117, paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, ndërsa

pretendimet e paraqitura në ankesë, për momentin, mbeten në nivel deklarativ, pasi nuk janë mbështetur me fakte dhe prova konkrete.

-PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e ankesës provave të bashkangjitura të njëjtës dhe përgjigjes në ankesë së bashku me prova, vëren se:

- Ankesa e ankuesit është e pabazuar.

Parashtruesi i ankesës pretendon se gjatë procesit të numërimit të votave dhe regjistrimit të tyre në sistemin elektronik në Qendrën Komunale të Numërimit në Ferizaj, komisioneri i subjektit politik LVV Albunit Murati ka anashkuar regjistrimin e votave të vlefshme të fituara nga kandidatja e PDK-së, Kaltrina Lohaj, duke ndikuar në rezultatin zgjedhor.

Neni 105 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se *“ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen në PZAP brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerëson se pretendimet e palës ankuese janë të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj. Fakti që gjatë numërimit është konstatuar se kandidates në fjalë Kaltrina Lohaj nuk i është regjistruar një votë, por më pas kjo është korrigjuar do të thotë është futur në sistem dhe është eliminuar si parregullsi. Ndërsa, pas shqyrtimit të ankesës dhe materialit të bashkëngjitur paneli konstatoi se ankuesi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse që do të vërtetonin pretendimet për manipulim të rezultatit zgjedhor, futje të pasaktë të dhënave apo veprim të kundërligjshëm nga personi i përmendur në ankesë.

Paneli vlerësoi se pretendimet e paraqitura mbështeten kryesisht në supozime dhe pohime të përgjithshme, pa u mbështetur në prova materiale, procesverbale zyrtare, regjistrime, raporte të verifikueshme ose dëshmi të tjera që do të demonstronin se ka ndodhur cenim i integritetit të procesit të numërimit dhe regjistrimit të votave.

Sipas parimit të barrës së provës, pala që pretendon një shkelje zgjedhore ka detyrimin të paraqesë prova të mjaftueshme që mbështesin pretendimet e saj. Në rastin konkret, pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë se me këto veprime komisioneri në fjalë ka ndikuar ose ka ndonjë parregullsi për të cilën pretendohet dhe e cila do të kishte ndikuar në procesin e numërimit dhe vlerësimit të fletëvotimeve, andaj për këto arsye, Paneli vlerëson se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paneli vlerëson se pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale të mjaftueshme që do të mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme.

Andaj neni 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nënin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa  
ZP.Anr.50/2026 më datën 15.06.2026

Kryesuesë e Panelit  
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.